



Nr. 168 Prot.

Datë 31.12.2018

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET**  
**AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**  
**DHE**  
**“OC INTERNATIONAL” Sh.p.k**  
**PËR PROMOVIMIN E KULTURËS**  
**DHE IDENTITETIT KOMBËTAR**

-



Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe “OC International” Sh.p.k (këtëj e tutje referuar si "Palët"),

Të inkurajuar nga dëshira e përbashkët për të nxitur promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në përhapjen e trashëgimisë kulturore kombëtare;

Janë dakorduar si vijon:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Palët, bazuar në angazhimin e ndërsjelltë, bashkëpunojnë me qëllim:

- a) Organizimin e eventeve, koncerteve dhe aktiviteteve kulturore në diasporë;
- b) Përhapjen e trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar;
- c) Ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;
- d) Ndërmarrjen e nismave të tjera në fushën e diasporës, që konsiderohen të nevojshme nga palët, në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje.

## **Neni 2**

### **Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit të ndërsjelltë, në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe fushën e kompetencave të tyre.
2. Palët vlerësojnë interesin dhe dëshirën e përbashkët për të zhvilluar forma të bashkëpunimit në përputhje me nenin 1 të kësaj marrëveshje.

## **Neni 3**

### **Format e bashkëpunimit**

Palët angazhohen për organizimin e aktiviteteve kulturore përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit të cilat përfshijnë:

- a) Organizimin e eventeve, koncerteve apo formave të tjera të aktiviteteve kulturore në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare, si dhe në Republikën e Shqipërisë;
- b) Promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar shqiptar në diasporë;



- c) Ofrimin e këshillimit të vazhdueshëm artistik dhe jo vetëm, për aktivitetet e parashikuara në programet vjetor të aktiviteteve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- d) Ofrimin e listës së shoqatave shqiptare kulturore, artistike apo dhomave të biznesit që veprojnë në diasporë;
- e) Nxitjen e organizimit të aktiviteteve në vendet ku gjendet diaspora shqiptare;
- f) Forma të tjera bashkëpunimi që nuk përmenden në këtë marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimin e sa, pasi palët të kenë shprehur dakordësinë me shkrim.

#### **Neni 4**

##### **Konfidencialiteti dhe Pronësia Intelektuale**

1. Palët kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me informacionin, të dhënat dhe njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë vlefshmërisë dhe/ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Të drejtat e pronësisë intelektuale palët do të vazhdojnë ti gazojnë veçmas, me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe përmes një marrëveshjeje me shkrim.
3. Të drejtat e pronësisë intelektuale në pronësi të një pale mund të përdoren nga pala tjetër për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje, vetëm me pëlqimin e shprehur me shkrim të palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga ajo palë.

#### **Neni 5**

##### **Përpunimi i të dhënave personale**

1. Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Të dhënat personale që njëra palë siguron nga pala tjetër, gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, mund t'i përdorë vetëm për sa kohë marrëveshja është në fuqi dhe në përputhje me qëllimin e saj.

#### **Neni 6**

##### **Bashkëpunimi me persona të tretë**

Kjo marrëveshje nuk përjashton mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj marrëveshjeje, me kusht që bashkëpunimet me palët e treta të mos bien ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.



## **Neni 7**

### **Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

## **Neni 8**

### **Kohëzgjatja, rinovimi dhe e drejta e tërheqjes**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.
2. Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje pa afat duke filluar nga data e hyrjes në fuqi.
3. Palët mund të tërhiqen nga kjo marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas gjashtë (6) muajsh nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshje, nuk përjashton përgjegjësinë e palëve për marrëdhëniet dhe detyrimet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi.

## **Neni 9**

### **Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

## **Neni 10**

### **Gjuha e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në dy kopje.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
TË DIASPORËS**

**DREJTORI EKZEKUTIV**

Dritan Delija

**PËR “OC INTERNATIONAL”  
Sh.p.k**

**ADMINISTRATORI**

Olen Çezari